

Data 24.02.2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“SHËRBIME TË PUBLIKIMIT DHE PRINTIMIT”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Publikime

Printime dhe shërbime të lidhura

VLERA E FONDIT LIMIT:

1 666 667 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa Tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore lëshuar nga Administrata Tatimore të 3 (tre) viteve të fondit, ku vlera të mos jetë më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë sepse ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, 2019, 2020 dhe 2021

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* i ndryshuar.

3.Një dokument që vërteton se (subjekti) i ka shlyer të gjitha detyrimet e taksave edhe tarifave vendore, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njësisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë, për vitet 2020-2021, kjo e vërtetuar me formularin e vetedeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “PërSistemin e TaksaveVendore” indryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurattatimore” indryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” indryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, nënjëvlerëjometëvogel se 20 % e vleres se perlllogariturtëkontrates

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM-së nr. 285, datë

19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jomëtëmadhe se 20% e vlerese se perllogariturtekontrates.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë aktivitetit të tij në Tiranë, shtypshkronja të jetë brenda vijës së verdhe të qytetit të Tiranës , kjo e vertetuar me certificate pronësie ose me kontratë qiraje e vlefshme per gjate gjithë periudhes se kontrates së kryerjes së shërbimit dhe përgjigjes 24 orë në rast të problemeve apo kërkesave, kryerjes së shërbimit në orët e vona të natës, etj. Për këtë arsye, është e nevojshmeqë OE të ketë selinë në Tiranë, në mënyrë që t’i pergjigjet kërkesave të AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4/ç të VKM nr.285 ,datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë qe zoteron pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit.

2.3.3 Të sigurojë montimin e materialeve të porositura kjo e vertetuar me nje deklarate nga Operatorit Ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar sherbimit te kerkuar si objekt prokurimi.

2.3.4 Afati i dorezimit te materialeve te kerkuara eshte (6) gjashte dite nga koha e berjes se kerkeses me email te institucionit per zerin e kerkuar nga Autoriteti Kontraktor kjo e vertetuar me nje deklarate nga Operatorit Ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar sherbimit te kerkuar si objekt prokurimi ne menyre qe operatori ekonomik te pergjigjet brenda afateve per kryerjen e sherbimit.

2.3.5 Të ofrojë lehtësi e printimeve në raste emergjente brenda ditës kjo e vertetuar me nje deklarate nga Operatorit Ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar sherbimit te kerkuar si objekt prokurimi ne menyre qe operatori ekonomik te pergjigjet brenda afateve per kryerjen e sherbimit.

2.3.6 Të ofrojë shërbim design falas (te perfshire ne oferte) për formatimin e materialeve, konceptimin e tyre kjo e vertetuar me nje deklarate nga Operatorit Ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar shërbimit të kërkuar si objekt prokurimi në mënyrë që operatori ekonomik të përgjigjet brenda afateve për kryerjen e shërbimit.

2.3.7 Operatori ekonomik të ketë të punësuar art designer me kontratë pune të vlefshme si dhe të rezultojë në listëpagesën e Operatorit Ekonomik për tre muajt e fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41 pika 4/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti/enti Kontraktormë anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion staf për të përmbushur kontratën .

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.